



1677

15.06.15

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 488 , datë 10.6.2015

P Ë R

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE
TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "C", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", çregjistrohet individi i renditur në shkronjën "a", të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas ndryshimeve në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

NIKO PELESHI

MINISTRI I PUNËVE
TË JASHTME

DITMIR BUSHATI

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E OKB-
së”)

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME
ORGANIZATËN AL-QAIDA**

a) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë
me organizatën Al-Qaida”;

1. ABDUL RAHIM; AL-TALHI.


Shënim: Gjeneralitet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër,
mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

NR.PROT.2548/1
DATË 10.6.2015

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
SHISH-IT
BANKËS SË SHQIPËRISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

A handwritten signature in black ink, reading "Engjell Agaçi", is written over a circular official stamp. The stamp contains text in Albanian, including "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" and "QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE".